

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 37 paragrafit 6 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18, 178/'21, 58/'24); nenit 163 dhe nenit 349 paragrafit 6 të Statutit të Universitetit të Tetovës; nenit 89 dhe nenit 90 paragrafit 6 të Statutit të Fakultetit të Arteve , dekani i Fakultetit, më datë 18.06.2026, solli këtë:

## **VENDIM**

### **për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës**

#### **Neni 1**

Shpallen zgjedhje për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës.

#### **Neni 2**

Anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të ndershme dhe demokratike me votim të fshehtë.

Kryetari i Kuvendit Studentor të Fakultetit, zgjidhet në mbledhjen e pare konstituive të Kuvendit studentor, nga radhët e anëtarve të zgjedhur, në përputhje me Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit.

#### **Neni 3**

Zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit do të mbahen me votim të fshehtë më datë 09.07.2026 (enjte), në sallën 82 të mbledhjeve të Fakultetit, me fillim nga ora 08:30 deri në orën 16:30.

#### **Neni 4**

Emërohet Komision Zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit, në këtë përbërje:

- 1) Prof.ord.Muamer Sadiku – mësimpldhënës në Fakultet – kryetar,
- 2) Prof.ord.Metin Izeti – mësimpldhënës në Fakultet – anëtar,
- 3) Nurten Zeqiri – student në semestrin VIII viti i IV studimeve në programin studimor Art Figurativ në vitin akademik 2025/2026, me numër indeksi: 221251 anëtar,
- 4) Trendelina Marku – student në semestrin VIII viti i IV studimeve në programin studimor Art Figurativ në vitin akademik 2025/2026, me numër indeksi: 220522 anëtar,
- 5) Valdrin Memeti – student në semestrin VIII viti i IV studimeve në programin studimor Art Figurativ në vitin akademik 2025/2026, me numër indeksi: 220085 anëtar,

#### **Neni 5**

- 1) Komisioni Zgjedhor nga neni 4 i këtij Vendimi:

- përcakton rregullat dhe miraton Udhëzuesin për procedurën e zhvillimit të zgjedhjeve;
- përcakton listën e kandidatëve të propozuar, bazuar në verifikimin paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u propozuar si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit (nëse janë studentë aktivë, pra të regjistruar në semestrin/vitin në të cilin mbahen zgjedhjet);
- e përcakton pamjen e fletës së votimit/formularëve të procesverbaleve, si dhe dokumentacionin tjetër që del nga rrjedha e procedurës për zhvillimin e zgjedhjeve;

- e përcakton mënyrën e votimit, numërimin e votave, dhe veprimin ndaj ankesave brenda një afati prej 24 orëve nga momenti i paraqitjes së tyre,
- kryen edhe detyra të tjera që lidhen me rrjedhën e zhvillimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit.

2) Udhëzuesi i Komisionit Zgjedhor publikohet në tabelën e shpalljeve/façen zyrtare të Fakultetit, jo më vonë se 7 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, së bashku me Vendimin për listën e përcaktuar të kandidatëve studentë që i plotësojnë kushtet (lista përfundimtare).

#### **Neni 6**

- (3) Kuvendi Studentor i Fakultetit përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues nga secili program studimor të njësisive të Universitetit,
- (4) Në rast se nuk plotësohet numri i anëtarëve për secilin program studimor, në përputhje me paragrafin e mëparshëm, për shkak të mungesës së studentëve që i plotësojnë kushtet, vendet e paplotësuara nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit, pra ai do të përbëhet nga aq anëtarë sa ka studentë që i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur dhe që do të jenë të zgjedhur.

#### **Neni 7**

Të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit kanë të gjithë studentët e Fakultetit, të cilët janë të regjistruar në studime gjatë vitit akademik në të cilin zgjidhet Kuvendi Studentor i Fakultetit.

Kryetari i Kuvendi Studentor i Fakultetit, mund të zgjidhet student i rregullt i cili ka të regjistruar semestrin veror të vitit akademik 2025/2026 me notë mesatare së paku 8.00 (tetë).

#### **Neni 8**

Anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Studentor të Fakultetit konsiderohen ata kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave nga studentët e Fakultetit që kanë votuar.

#### **Neni 9**

Komisioni Zgjedhor obligohet që t'i zhvillojë zgjedhjet në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit dhe Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit.

#### **Neni 10**

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe publikohet në tabelën e shpalljeve/façen zyrtare të Fakultetit.



**Dekani,**  
**Prof. Mr. Senad Abdulic**